

## Raporti Mujor Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRrE)

### Mars 2007

- **04 mars 2007** - Takim me Sh.A „KOSTT“, konsultime për të ardhurat e lejuara dhe planin e shpenzimeve kapitale (Capex);
- **06 mars 2007** - Sektori i energjisë në Kosovë- studimi i tregut të ngrohjes (takim pune, banka botërore , MEM );
- **08 mars 2007** - Takim me ngrohtoret, NQ „Termokos“ dhe NQ „Gjakova“, për shqyrtimin e çmimoreve për intervenime në rrjetin sekondar;
- **08 mars 2007** - Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK) ka zgjidhur (vendosur) 3 ankesa të konsumatorëve;
- **09 mars 2007** - Mbledhje pune mbi burimet e ripërtëritjes së energjisë, Bruksel, Belgjikë;
- **13 mars 2007** - Aprovimi i të dhënave elektrike për ERRA dhe të dhënat shpjeguese për të dhënat e siguruara;
- **14 mars 2007** - Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK) ka pasur takim me KEK-un (departamentin për kujdes ndaj konsumatorëve) dhe konsumatorin (rreth zgjidhjes alternative të kontesteve);
- **15 mars 2007** - Mbledhja e bordit të ZRRrE-së;
- **15 mars 2007** - Përgatitja e vendimeve (D-40), aprovimi i kërkesës për „Çmimoren e shërbimeve në rrjetin sekondar të instalimeve“ të NQ „Termokos “ dhe NQ „Gjakova“;
- **15 mars 2007** - Vendimet e KEK Sh.A, për miratimin e tarifave të reja, të miratuara nga bordi i ZRRrE-së;
- **15 mars 2007** - Vendimet e KOSTT Sh.A, për miratimin e tarifave të reja të bartjes, të miratuara nga bordi i ZRRrE-së;
- **19 mars 2007** - Tarifa fikse për konsumatorë, e lejuar nga ZRRrE për KEK-un (furnizuesin publik);
- **19 mars 2007** - Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK) takim me KEK-un (departamentin për kujdes ndaj konsumatorëve) dhe konsumatorin (rreth zgjidhjes alternative të kontesteve);
- **26-27 mars 2007** – Grupi Punues Rregullimi Ligjor, Stamboll, Turqi

### Aktivitete tjera të rregullta të kryera nga ZRRrE;

- Takime me përfaqësues të të licencuarve lidhur me sqarimin e disa termave dhe kushteve të licencës.
- Pranimi i raporteve vjetore të pajtueshmërisë me kushtet e licencave, për vitin 2006, të dorëzuara nga të licencuarit e në përputhje me Doracakun e Raportimit.
- Vlerësimi i raporteve vjetore të pajtueshmërisë me kushtet e licencave, të dorëzuara nga të licencuarit, e në përputhje me Doracakun e Raportimit.
- Në muajin mars departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK) ka regjistruar rreth 6 ankesa të konsumatorëve.